



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3559 Prot

Shkodër, më 13.02.2026

VENDIM

Nr. 51 datë 13/02/2026

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 “Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjit nr.75/2019 “Për rininë”; Udhëzimi nr. 30/2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.31, datë 30.01.2026.
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, znj.Teuta Qyteza me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër;
- Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ për:
 - Drejtorinë e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë
 - Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
 - Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe.
2. Zv/Kryetarja nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 17.02.2026 dhe përfundojnë me datë 30.06.2026, ora 16.00.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet znj.Teuta Qyteza dhe administrata bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

